



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

REPublika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT	
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA, TRGOVINE I INOVACIJA	
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP, TRADE AND INNOVATION	
Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr Prot. Broj Prot. Prot.No	2992
Nr. i faqeve Broj stranica No pages	
Data: Datum: Date:	03, 07, 2026
PRISHTINË/A	

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit*  
*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija*  
*Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation*

*Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister*

Nr. ref. 01/102

Data: 03/07/2026

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit Nr.06/L-113 Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, neni 30 dhe 31 të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme, nenit 5 paragrafi 3 dhe paragrafin 4, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse, nenit 1 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.09/2022 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) NR. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse, nenit 20 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nxjerr:

## **V E N D I M**

1. Vendoset rregullimi i përkohshëm i çmimeve dhe caktohen masat e tjera mbrojtëse për produktet e naftës të përdorshme në transport, si vijon:

1.1. Çmimi maksimal i shitjes me shumicë domethënë çmimi mesatar i furnizimit me produktin (sipas evidencës ditore nga Dogana e Kosovës), plus dy (2) eurocentë.

1.2. Çmimi maksimal i shitjes me pakicë domethënë çmimi mesatar i furnizimit me produktin i paraparë në paragrafin 1.1. të këtij neni, plus dymbëdhjetë (12) eurocentë.

1.3. Çmim mesatar i furnizimit për dizelin domethënë mesatarja e çmimeve për litër me të cilët janë importuar dhjetë milionë (10.000.000) litrat e fundit, me evidence ditore nga Dogana e Kosovës.

1.4. Çmim mesatar i furnizimit për çdo karburant përpos dizelit domethënë mesatarja e çmimeve për litër me të cilët janë importuar një milion (1.000.000) litrat e fundit të produktit me evidence ditore nga Dogana e Kosovës.

- 1.5. Detyrohen subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregtinë e produkteve të naftës të resepektojnë cmimin maksimal sipas këtij vendim dhe të sigurojnë furnizimin dhe ofrimin për shitje të produkteve të naftës, si para vendosjes së çmimeve dhe masave mbrojtëse;
- 1.6. Autoritetet inspektuese intensifikojnë mbikëqyrjen e tregut për të siguruar zbatimin e këtij vendimi;
- 1.7. Në rast të dyshimeve për praktikë të ndaluar ose cënim të konkurrencës së lirë në treg, rastet paraqiten në formë të përshpejtuar tek Autoriteti i Konkurrencës.
2. Rregullimi i çmimeve dhe masat nga pika 1 e këtij Vendimi, mbeten në fuqi tridhjetë (30) ditë, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
3. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij vendimi bëhet nga Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës si dhe Administratën Tatimore të Kosovës.
4. Mosrespektimi i kufizimit të çmimit të produkteve të naftës ose karburanteve ndëshkohet me gjobë, ndërsa në rast të përsëritjes së shkeljes shqiptohet ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë si dhe masa të tjera ndëshkuese dhe administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **A r s y e t i m**

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit ka monitoruar rregullisht tregjet e produkteve të naftës dhe bazuar në evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës lidhur me çmimet e furnizimit/ importit të produkteve të naftës si dhe raportet e përditshme nga Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut lidhur me çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës. Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se lëvizjet e çmimeve në tregun ndërkombëtar reflektohen në tregun e brendshëm kryesisht në rastet e rritjes së çmimeve, ndërsa në rastet e rënies së çmimeve reflektimi është i kufizuar ose i vonuar. Prandaj, jo proporcionaliteti i çmimeve të naftës të deklaruar në import si dhe çmimeve në tregun tonë të brendshëm përbëjnë shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse sipas nenit 15, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, nenit 3 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.3 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse. Ky disproporcion ndërmjet çmimeve të deklaruar në import dhe çmimeve të shitjes në tregun e brendshëm mund të krijojë çrregullime në funksionimin e tregut dhe të dëmtojë interesin e konsumatorëve.

Rregullimi i çmimeve dhe masave tjera mbrojtëse, caktohen në bazë të nenit 5, nenit 1 i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.09/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2022 për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga rritjet e pajustificueshme të çmimeve, për të mbrojtur konkurrencën, për të mënjeluar çrregullimet në treg dhe të sigurojë funksionimin normal dhe transparent të tregut të produkteve të naftës.

Llogaritja e çmimit maksimal të lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 5 paragrafi 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe nenit 1 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.09/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2022 për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës.

Duke u bazuar në analizën e situatës në treg dhe kompetencat ligjore të Ministrisë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi një (1) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Mimoza KUSARI - LILA

Ministër në detyrë



**Vendimi i dërgohet:**

- Kabinetit të Zyrës së Kryeministrit në detyrë;
- Kabinetit të Ministres në detyrë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINTI;
- Doganës së Kosovës;
- Administratës Tatimore të Kosovës;
- Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;
- Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MINT.